



02 Nr. 132 /25
Me 29.07 2025
Mamushë

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/1-212 i Punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin e Bllokut Kodues në Listën e Pagave

Neni 1

Për të punësuarin z. **Erدينç Morina**, i cili ushtron funksionin e **Inspektorit Komunal në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike**, bëhet **ndryshimi i Bllokut Kodues**, dhe i njëjti do të kategorizohet në **Bllokun Kodues 10/626/18014/0451**, në përputhje me strukturën organizative dhe nevojat funksionale të drejtorisë përkatëse.

Neni 2

Me këtë vendim, obligohet **Zyra e Personelit** që të bëjë **reflektimin e ndryshimit të Bllokut Kodues në sistemin e pagave**, dhe të sigurohet që i punësuarin të përfshihet në **listën e pagave sipas bllokut të ri të përcaktuar në nenin 1** të këtij vendimi. Njëkohësisht, **duhet të lirohet vendi ku ka qenë i pozicionuar më parë i punësuarin në sistemin e pagave**, në mënyrë që të mos ketë dyfishim të pozitës në nivel të kodimit.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


ARSYETIM

Z. **Erدينç Morina** aktualisht ushtron pozitën e Inspektorit Komunal në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, mirëpo në sistemin e pagave ka qenë i regjistruar në një bllok kodues që nuk reflekton përkatësinë e tij reale funksionale dhe organizative. Për këtë arsye, për të siguruar përputhshmëri ndërmjet vendit të punës dhe përfaqësimit në sistemin e pagave, është bërë kategorizimi i tij në Bllokun Kodues 10/626/18014/0451, që i përket kësaj drejtorie. Ky ndryshim është në përputhje me parimet e administrimit të pagave publike, dhe synon saktësimin e të dhënave financiare dhe organizative për çdo pozitë të sistemuar në institucion.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikës - Dalëse - Izlazna - Outgoing		
02	No.Nr.	131-25
Tarih/Dt.		29.07.2025

02 Nr. 131-25
Datë: 29.07/2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/I-196 për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me Ligjin nr. 03/I-212 të Punës, dhe nenin 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M **Për Ndalimin e pagës**

Neni 1

Znj. **Hulkiye Mazrek**, e punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Mamushës, ka realizuar lindjen më datë 10.07.2025 dhe ka kaluar në pushim të lehonisë nga kjo datë, gjë që është vërtetuar me dokumentacion përkatës nga Spitali i Përgjithshëm "Dr. Daut Mustafa" në Prizren.

Neni 2

Punonjësja e ka parashtruar kërkesën për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë më datë 17.07.2025, pra pas fillimit të pushimit faktik, dhe për shkak të mosparaqitjes në kohë të kërkesës, nuk është bërë ndryshimi në sistemin e pagave për muajin korrik. Si rezultat, paga për muajin korrik është ekzekutuar në vlerën e plotë në vend të 70% të pagës bazë, ashtu siç parashihet me nenin 49 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.

Neni 3

Për pasojë, nga paga e muajit gusht 2025 duhet të bëhet ndalesa në shumën prej 211.73 €, me qëllim që paga të harmonizohet me përqindjen që i takon të punësuarës sipas legjislacionit në fuqi për pushimin e lehonisë.

Neni 4

Obligohet- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për realizimin e këtij vendimi dhe zbatimin e ndalesës së përcaktuar në nenin 3 të këtij vendimi.

Neni 5

Kjo ndalesë zbatohet vetëm për muajin Gusht 2025, me qëllim të balancimit të pagës së muajit korrik, gjatë të cilit është realizuar pagesa e plotë për shkak të mosparaqitjes me kohë të kërkesës për pushim të lehonisë. Pas këtij muaji, paga e punonjësës do të vazhdojë të ekzekutohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht 70% e pagës bazë për periudhën e mbetur të pushimit të lehonisë.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me datë 17.07.2025, ka pranuar kërkesën e znj. Hulkiye Mazrek për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë, megjithëse lindja ka ndodhur më datë 10.07.2025. Për shkak të mosparaqitjes së kërkesës në kohën e duhur, nuk ka qenë e mundur që të bëhet përditësimi në sistemin e pagave për muajin korrik, dhe rrjedhimisht është llogaritur dhe paguar paga e plotë, në kundërshtim me dispozitat e nenit 49 të Ligjit të Punës, ku përcaktohet se gjatë pushimit të lehonisë punonjësës i takon 70% e pagës bazë, për 6 muajt e parë.

Pas përditësimit të dhënave në muajin gusht 2025 dhe zbatimit të normave ligjore për periudhën përkatëse, është e nevojshme të bëhet kompensimi për tej pagimin e muajit korrik, bëhet përmes ndalesës në shumën 211.73 €, nga paga e muajit Gusht duke u bazuar në normat financiare dhe ligjore në fuqi.

Njoftohen


- DSHMS
- Thesari-MFPT
- Arkivi





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 130-25
Me 28.07 2025

Në bazë nenit 13 dhe 58 paragrafi 1 pika (b) të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, lidhur me nenin 21 të Ligji nr. 08/l-197 Për Zyrtarët Publik, Nenin 49 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe nenit 13 të Rregullore (QRK) nr. 04/2024 Për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik dhe Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr. 01/2018 Për Rregullimin e Procedurave Administrative të Kompensimit Për Pushimin e Lehonisë të Paguar nga Qeveria, Kërkesës së Parashtruar pranë DSHMS me numër të protokollit 08.Nr.16/25 e datës 17.07.2025 Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M Për Pushim të Lehonisë

Neni 1

znj. **Hulkiye Mazrek**, me numër personal 1175214875, e punësuar në pozitën Infermiere pranë QKMF-së në Mamushë, i lejohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, duke filluar nga data 10.07.2025 deri më 10.07.2026.

Neni 2

Pagesa për gjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë, nga data 10.07.2025 deri më 10.01.2026, do të bëhet nga punëdhënësi në lartësi prej 70% të pagës bazë, nga mjetet buxhetore të institucionit ku e punësuar është në marrëdhënie pune.

Neni 3

Pagesa për tre (3) muajt në vijim, nga data 10.01.2026 deri më 10.04.2026, do të bëhet nga Qeveria e Kosovës, në lartësi prej 50% të pagës mesatare në Kosovë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

E punësuar ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të shfrytëzojë edhe tre (3) muaj pushim të papaguar, duke filluar nga data 10.04.2026 deri më 10.07.2026.

Neni 5

Ky vendim fillon të prodhon fuqi Juridike nda data nënshkrimit.

A R S Y E T I M

znj. **Hulkiye Mazrek**, me numër personal 1175214875, e punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Mamushës, më datë 10.07.2025 ka realizuar lindjen, e cila është vërtetuar me fletëlëshim nga Spitali i Përgjithshëm "Dr. Daut Mustafa" në Prizren, me numër protokolli 8860, i lëshuar nga Departamenti për Nënë dhe Fëmijë – Reparti i Neonatologjisë. Po ashtu, bazuar në kërkesën e parashtruar për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë, me nr. protokolli 08/Nr.-16/25, të datës 17.07.2025, të paraqitur në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, është proceduar kjo çështje.

Pas përfundimit të pushimit të lehonisë, të paraparë me nenin 49 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, si dhe nenin 13, paragrafi I të Rregullores (QRK) nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publikë, e njëjta duhet të kthehet në vendin e saj të punës.

Nëse lehona nuk dëshiron ta shfrytëzojë të drejtën për pushim të lehonisë sipas pikës II dhe III të këtij vendimi, ajo duhet të njoftojë punëdhënësin më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë para përfundimit të pushimit nga paragrafi I i këtij vendimi. Po ashtu, edhe nëse lehona nuk e shfrytëzon pushimin sipas pikës II dhe III, ajo gëzon të drejtën e ushqyerjes së foshnjës me qumësht gjiri, në përputhje me ligjin përkatës për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri.


Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh në Komisionin për ankesa dhe parashtrës në Komunën e Mamushës.

Me këtë vendim njoftohet:

- znj. Hunkiye Mazrek;
- QKMF
- DSHMS
- ARKIVI.

Kryetari i Komunës së Mamushës






02 Nr. 129/25
Me 29.07.2025
Mamushë

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/L-212 i Punës, Vendimi me numër të protokollit 02 Nr.122/25 të datës 29.07.2025 Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil të punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin në Listë të Pagave

Neni 1

Z. Engin Taç, nga Komuna e Mamushës, është emëruar në pozitën Zyrtar i Lartë Financiar në Komunën e Mamushës, në bazë të vendimit Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil të marrë nga Kryetari i Komunës së Mamushës, me numër protokollit 02 Nr.128/25 të datës 29.07.2025, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me nevojat organizative të institucionit.

Neni 2

Obligohet- Zyra e Personelit në Komunën e Mamushës që për të lartcekurin ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të ndryshimit në listë të pagave në bazë të Aktemërim kategorisë Profesional 1, sipas koeficientit 6.56 (Klasa GJ32 sipas LigjitNr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Z. Engin Taç, i cili deri më tani ka ushtruar funksionin e Zyrtarit Financiar në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, pas vlerësimit të nevojave profesionale dhe organizative brenda kësaj drejtorie, si dhe në përputhje me procedurat ligjore dhe administrative, është sistemuar në pozitën e re të Zyrtarit të Lartë Financiar, brenda së njëjtës drejtori në Komunën e Mamushës. Ky transferim paraqet një lëvizje të brendshme që synon rritjen e kapaciteteve profesionale në menaxhimin financiar, si dhe përmirësimin e funksionimit buxhetor, raportimit dhe kontrollit të brendshëm, në përputhje me kërkesat gjithnjë në rritje të punës dhe standardet e efikasitetit institucional.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva


Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02Nr. 128-25
Me 29.07.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, neni 65 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Neni 11 Rregullore (QRK) nr. 02/2024 Për Transferimin e Nëpunësve Civilë, 82 Statutit të Komunës së Mamushës.

V E N D I M

Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil

Neni 1

z. Engin Taç nga pozita Zyrtar Financiar në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, transferohet në Zyrtar i Lartë Financiar, në kuadër të Drejtorisë së njëjtë në Komunën e Mamushës.

Neni 2

Vendimi i ri i punës është i kategorisë Profesional 1, sipas koeficientit 6.56 (Klasa GJ32 sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).

Neni 3

Nëpunësi fillon punën si Zyrtar Për Kadastër nga data 01.08.2025.

Neni 4

Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që brenda afatit Ligjor ta bëjë përditësimin në Aktemërimin e nëpunësit civil.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Mamushës.

A R S Y E T I M

z. Engin Taç, i punësuar në vendin e punës Zyrtar Financiar në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për shkak të rritjes së vëllimit të punës në këtë drejtori, që ka ardhur si rezultat i shtimit të projekteve publike, intensifikimit të kërkesave për menaxhimin financiar të shërbimeve komunale dhe domosdoshmërisë për përgatitje më të detajuar të raporteve financiare, vendoset që të transferohet në pozitën Zyrtar i Lartë Financiar, duke vazhduar angazhimin e tij brenda së njëjtës drejtori – Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Në këtë vendim është marrë parasysh përvoja e tij shumëvjeçare në administrimin e buxhetit komunal dhe menaxhimin e procedurave financiare, si dhe aftësia për të bashkëpunuar ngushtë me njësitë tjera të drejtorisë në funksion të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve publike, që janë elemente kyçe për pozitën e Zyrtarit të

Lartë Financiar. Kjo përvojë përbën bazë të fuqishme për ushtrimin me kompetencë dhe efikasitet të përgjegjësive të reja në kuadër të kësaj pozite.

Transferimi i nëpunësit civil brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunësit civil, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.


Duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil, Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit civil Përgatitja profesionale e nëpunëses/it që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet Transferimi i nëpunëses/it civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësen/in e drejtpërdrejtë, udhëheqësen/in më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses/it civil.

Prandaj, duke u bazuar në dispozitat e lartëcekura, Kryetari i Komunës konstaton se nevoja për transferimin e përhershëm është e arsyeshme.

Prandaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim njoftohet:

- z. Engin Taç;
- DZHPUGJK;
- Personeli
- arkivi.





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 127/25
Me 29.07.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/L-212 i Punës, Vendimi me numër të protokollit 02 Nr.123/25 të datës 29.07.2025 për përcaktimin e kategorisë së vendit të punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin në Listë të Pagave

Neni 1

Znj. Kubra Taç, nga Komuna e Mamushës, e emëruar në pozitën Zyrtare Për Gjendje Civile në Komunën e Mamushës, në bazë të vendimit Për përcaktimin e kategorisë së vendit të punës, të marrë nga Kryetari i Komunës së Mamushës, me numër protokollit 02 Nr.123/25 të datës 29.07.2025, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me nevojat organizative të institucionit,

Neni 2

Obligohet- Zyra e Personelit në Komunën e Mamushës që për të lartcekurin ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të ndryshimit në listë të pagave në bazë të Aktemërim kategorisë Profesional 2, sipas koeficientit 5.75 (Klasa GJ40 sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nga blloku kodues 10-626-16314-0133.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.


ARSYETIM

Znj. Kubra Taç, e cila ushtron funksionin e Zyrtares për Gjendje Civile në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, në pajtim me Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, i është bërë kategorizimi i pozitës në përputhje me klasifikimin e paraparë në katalog. Kjo kategorizim është bërë brenda së njëjtës drejtori – Drejtoria e Administratës së Përgjithshme në Komunën e Mamushës – dhe ka për qëllim harmonizimin e pozitave të punës me strukturën dhe standardet e përcaktuara për shërbimin civil të kadastrit dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në këtë sektor.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 126/25
Me 29.07.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/1-212 i Punës, Vendimi me numër të protokollit 02 Nr.122/25 të datës 29.07.2025 Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil të punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M
Për ndryshimin në Listë të Pagave

Neni 1

Z. Resit Mazrek, nga Komuna e Mamushës, është emëruar në pozitën Zyrtar Për Kadastër në Komunën e Mamushës, në bazë të vendimit Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil të marrë nga Kryetari i Komunës së Mamushës, me numër protokollit 02 Nr.122/25 të datës 29.07.2025, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me nevojat organizative të institucionit.

Neni 2

Obligohet- Zyra e Personelit në Komunën e Mamushës që për të lartcekurin ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të ndryshimit në listë të pagave në bazë të Aktemërim kategorisë Profesional 2, sipas koeficientit 5.75 (Klasa GJ40 sipas LigjitNr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nga blloku kodues 10/626/65070/0610.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Z. Resit Mazrek, i cili deri më tani ka ushtruar funksionin e Teknikut të Gjeodezisë në kuadër të Drejtorisë për Zhvillim, Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër, pas vlerësimit të nevojave profesionale dhe organizative, si dhe në përputhje me procedurat ligjore dhe administrative, është sistemuar në pozitën e re të Zyrtarit për Kadastër, brenda së njëjtës drejtori në Komunën e Mamushës. Ky transferim paraqet një lëvizje të brendshme që synon forcimin e kapaciteteve të kadastrit dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në këtë sektor.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva


Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 125/25
Me 29.07.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/1-212 i Punës, Vendimi me numër të protokollit 02 Nr.121/25 të datës 29.07.2025 Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil të punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin në Listë të Pagave

Neni 1

Znj. Sibel Taç, nga Komuna e Mamushës, është emëruar në pozitën Zyrtar Për Mirëqenies Socilae në Komunën e Mamushës, në bazë të vendimit Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil të marrë nga Kryetari i Komunës së Mamushës, me numër protokollit 02 Nr.121/25 të datës 29.07.2025, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me nevojat organizative të institucionit.

Neni 2

Obligohet- Zyra e Personelit në Komunën e Mamushës që për të lartcekurin ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të ndryshimit në listë të pagave në bazë të Aktemërim kategorisë Profesional 2, sipas koeficientit 5.75 (Klasa GJ40 sipas LigjitNr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nga blloku kodues 10/626/75566/1040.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Znj. Sibel Taç, e cila deri më tani ka ushtruar funksionin e Zyrtares për Arkiv (nivel 3) në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pas vlerësimit të nevojave organizative dhe në përputhje me procedurat ligjore dhe administrative, është sistemuar në pozitën e re të Zyrtares për Mirëqenie Sociale brenda së njëjtës drejtori. Ky transferim përfaqëson një lëvizje të brendshme institucionale që synon përmirësimin e funksionalitetit dhe efikasitetit të shërbimeve në fushën e mirëqenies sociale.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 124/25
Me 29.07.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/L-212 i Punës, Vendimi me numër të protokollit 02 Nr.120/25 të datës 29.07.2025 Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil të punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M
Për ndryshimin në Listë të Pagave

Neni 1

Z. Nusret Morina, nga Komuna e Mamushës, është emëruar në pozitën Zyrtar Për Logjistikë në Komunën e Mamushës, në bazë të vendimit Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil të marrë nga Kryetari i Komunës së Mamushës, me numër protokollit 02 Nr.120/25 të datës 29.07.2025, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me nevojat organizative të institucionit.

Neni 2

Obligohet- Zyra e Personelit në Komunën e Mamushës që për të lartcekurin ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të ndryshimit në listë të pagave në bazë të Aktemërim kategorisë Profesional 2, sipas koeficientit 5.75 (Klasa GJ40 sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nga blloku kodues 10/626/16314-0133.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Z. Nusret Morina, i cili deri më tani ka ushtruar funksionin e Zyrtarit për Arkiv në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, pas vlerësimit të nevojave të institucionit dhe në përputhje me procedurat ligjore dhe administrative, është sistemuar në pozitën e re të Zyrtarit për Logjistikë, brenda së njëjtës drejtori në Komunën e Mamushës. Ky transferim paraqet një lëvizje të brendshme me qëllim të optimizimit të funksionimit administrativ dhe menaxhimit më efikas të burimeve logjistike.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva


Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02Nr.123-25
Me 29.07.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligji nr. 08/l-196 Për Pagat në Sektorin Publik Katalogun e Vendeve të Punës, pika 1118, 82 Statutit të Komunës së Mamushës.

V E N D I M

Për përcaktimin e kategorisë së vendit të punës të nëpunës civilë

Neni 1

Znj. Kubra Taç, Zyrtare për Gjendje Civile në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, në pajtim me Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, bëhet kategorizimi i pozitës së saj në kuadër të së njëjtës drejtori, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme në Komunën e Mamushës, në përputhje me klasifikimin e paraparë në katalog.

Neni 2

Pozita klasifikohet me koeficientin 5.75, që i përket Klasës GJ40, sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, dhe bën pjesë në Kategorinë Profesionale 2.

Neni 3

Përcaktimi i ri i kategorisë zbatohet nga data 01.08.2025.

Neni 4

Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që brenda afatit ligjor të bëjë përditësimin në aktemërimin e nëpunës civilë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Mamushës.

A R S Y E T I M

Znj. Kubra Taç, e punësuar në vendin e punës Zyrtare për Gjendje Civile në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, në kategorinë Profesionale 3, për shkak të harmonizimit të pozitës së saj me strukturën organizative dhe përputhshmëri me Katalogun e Vendeve të Punës, ku pozita e Zyrtares për Gjendje Civile parashihet të jetë në kategorinë Profesionale 2, bëhet përcaktimi i kategorisë së vendit të punës në përputhje me katalogun, duke u klasifikuar në kategorinë Profesionale 2, në të njëjtën pozitë dhe drejtori – Drejtoria e Administratës së Përgjithshme në Komunën e Mamushës.

Në këtë vendim, kategorizimi i pozitës në Kategorinë Profesionale 2 është bërë në përputhje me Katalogun zyrtar të klasifikimit të pozitave, i cili e parasheh këtë kategori

për pozitën përkatëse. Pozita klasifikohet me koeficient 5.75 dhe i takon Klasës GJ40, sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Ky përcaktim është bërë në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses civile, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe në përputhje me Katalogun e Vendeve të Punës të miratuar.

Prandaj, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim njoftohet:

- znj. Kubra Taç;
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;
- Personeli
- arkivi.





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikës - Dalëse - Izlaza - Outgoing		
No.Nr. 122-25		
Tarih/Dt. 29.07.2025		

02Nr. 122-25
Me 29.07.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, neni 65 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Neni 11 Rregullore (QRK) nr. 02/2024 Për Transferimin e Nëpunësve Civilë, 82 Statutit të Komunës së Mamushës.

V E N D I M

Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil

Neni 1

z. Resit Mazrek nga pozita Teknik i Gjeodezisë në kuadër të Drejtorisë për Zhvillim, Planifikim, Urbanizëm Gjeodezi dhe Kadastër transferohet në Zyrtar Për Kadastër, në kuadër të Drejtorisë së njëjtë në Komunën e Mamushës.

Neni 2

Vendi i ri i punës është i kategorisë Profesional 2, sipas koeficientit 5.75 (Klasa GJ40 sipas LigjitNr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik)

Neni 3

Nëpunësi fillon punën si Zyrtar Për Kadastër nga data 01.08.2025.

Neni 4

Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që brenda afatit Ligjor ta bëjë përditësimin në Aktemërimin e nëpunësit civil.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Mamushës.

A R S Y E T I M

z.Resit Mazrek, i punësuar në vendin e punës Teknik i Gjeodezisë në kuadër të Drejtorisë për Zhvillim, Planifikim, Urbanizëm Gjeodezi dhe Kadastër, për shkak të nevojës së shprehur të institucionit për angazhim të një Zytari për Kadastër, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve kadastrale, administrimit të të dhënave pronësore dhe përmbushjes së kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve për dokumentacion të saktë dhe të përditësuar, vendoset që z. Resit Mazrek, nga pozita Teknik i Gjeodezisë, të transferohet në pozitën Zytar për Kadastër në kuadër të Komunës së Mamushës.

Në këtë vendim është marrë parasysh edhe përvoja e tij profesionale në fushën e gjeodezisë, gjatë së cilës ka dëshmuar aftësi teknike dhe organizative në përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave të hapësirës dhe pronësisë, që përbëjnë kompetenca thelbësore dhe të aplikueshme në pozitën e Zytarit për Kadastër. Kjo përvojë profesionale përbën

bazë të qëndrueshme për përmbushjen me efikasitet të detyrave dhe përgjegjësi që kërkohen në pozitën e re.

Transferimi i nëpunësit civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunësit civil, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil, Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit civil Përgatitja profesionale e nëpunëses/it që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet Transferimi i nëpunëses/it civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësen/in e drejtpërdrejtë, udhëheqësen/in më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses/it civil.

Prandaj, duke u bazuar në dispozitat e lartëcekura, Kryetari i Komunës konstaton se nevoja për transferimin e përhershëm është e arsyeshme.

Prandaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim njoftohet:


- z. Resit Mazrek;
- DZHPUGJK;
- Personeli
- arkivi.





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02Nr.121/25
Me 29.07..2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, neni 65 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Neni 11 Rregullore (QRK) nr. 02/2024 Për Transferimin e Nëpunësve Civilë, 82 Statutit të Komunës së Mamushës.

V E N D I M

Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil

Neni 1

Znj. Sibel Taç, e punësuar në pozitën Zyrtare për Arkiv – niveli 3 në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, transferohet në pozitën Zyrtare për Mirëqenie Sociale, brenda së njëjtës drejtori.

Neni 2

Vendi i ri i punës është i kategorisë Profesional 2, sipas koeficientit 5.75 (Klasa GJ40 sipas LigjitNr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).

Neni 3

Nëpunësi fillon punën si Zyrtare për Mirëqenie Sociale nga data 01.08.2025.

Neni 4

Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që brenda afatit Ligjor ta bëjë përditësimin në aktemërimin e nëpunësit civil.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Mamushës.

A R S Y E T I M

znj. Sibel Taç, e punësuar në vendin e punës Zyrtar për Arkiv 3 në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për shkak të nevojës së shprehur të institucionit për angazhim të një Zyrtare për Mirëqenie Sociale, me qëllim të forcimit të ofrimit të shërbimeve sociale, koordinimit më efikas të asistencës dhe mbështetjes për grupet në nevojë, si dhe përmbushjes së objektivave të mirëqenies sociale në nivel komunal, vendoset që znj. Sibel Taç nga pozita Zyrtar për Arkiv 3 në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të transferohet në pozitën Zyrtare për Mirëqenie Sociale në kuadër të Komunës së Mamushës.

Në këtë vendim është marrë parasysh edhe përvoja e saj shumëvjeçare si arkiviste, gjatë së cilës ka dëshmuar përgjegjësi, saktësi dhe aftësi të larta organizative në menaxhimin e

dokumentacionit dhe proceseve të brendshme administrative, të cilat janë kompetenca të rëndësishme dhe të aplikueshme edhe në pozitën e re. Kjo përvojë profesionale përbën një bazë të qëndrueshme për përmbushjen me efikasitet të detyrave dhe përgjegjësi të kërkuara në pozitën e Zyrtares për Mirëqenie Sociale.

Transferimi i nëpunëses civile brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses civile, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil, Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit civil Përgatitja profesionale e nëpunëses/it që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet Transferimi i nëpunëses/it civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësen/in e drejtpërdrejtë, udhëheqësen/in më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses/it civil.

Prandaj, duke u bazuar në dispozitat e lartëcekura, Kryetari i Komunës konstaton se nevoja për transferimin e përhershëm është e arsyeshme.

Prandaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim njoftohet:

- z. Sibel Taç;
- DSHMS;
- Personeli
- arkivi.





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr.120/25
Me 29.07.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, neni 65 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Neni 11 Rregullore (QRK) nr. 02/2024 Për Transferimin e Nëpunësve Civilë, 82 Statutit të Komunës së Mamushës.

V E N D I M

Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil

Neni 1

z. **Nusret Morina** zyrtar i Arkivit në kuadër të drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, transferohet në Zyrtar për Logjistikë, pranë Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme në Komunën e Mamushës.

Neni 2

Vendi i ri i punës është i kategorisë Profesional 2, sipas koeficientit 5.75 (Klasa GJ40 sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik)

Neni 3

Nëpunësi fillon punën si Zyrtar i Logjistikës nga data 01.08.2025.

Neni 4

Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që brenda afatit Ligjor ta bëjë përditësimin në aktemërimin e nëpunësit civil.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Mamushës.

A R S Y E T I M

z. **Nusret Morina**, i punësuar në vendin e punës Zyrtar për Arkiv në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, për shkak të nevojës së shprehur të institucionit për angazhim të një Zyrtari për Logjistikë, me qëllim të menaxhimit më efikas të burimeve logjistike, organizimit të shpërndarjes dhe furnizimeve të brendshme, si dhe koordinimit të nevojave materiale dhe teknike të administratës komunale, vendoset që z. **Nusret Morina** nga pozita Zyrtar për Arkiv në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të transferohet në pozitën Zyrtar për Logjistikë në kuadër të Komunës së Mamushës.

Në këtë vendim është marrë parasysh edhe përvoja e tij shumëvjeçare si arkivist, gjatë së cilës ka dëshmuar përgjegjësi, saktësi dhe aftësi organizative në menaxhimin e dokumentacionit dhe proceseve të brendshme, të cilat janë kompetenca të rëndësishme

dhe të transferueshme për pozitën e Zyrtarit për Logjistikë. Kjo përvojë e tij e mëhershme përbën bazë të qëndrueshme për përmbushjen me efikasitet të detyrave dhe përgjegjësi që kërkohen në pozitën e re.

Transferimi i nëpunësit civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunësit civil, ashtu siç kërkohet me legjislacionin përkatës në fuqi.


Duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit civil Përgatitja profesionale e nëpunëses/it që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet Transferimi i nëpunëses/it civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësen/in e drejtpërdrejtë, udhëheqësen/in më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses/it civil.

Prandaj, duke u bazuar në dispozitat e lartëcekura, Kryetari i Komunës konstaton se nevoja për transferimin e përhershëm është e arsyeshme.

Prandaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim njoftohet:


- z. Nusret Morina;
- Drejtorja e Administratës së Përgjithshme;
- Personeli
- arkivi.





Republika e Kosovës – Kosova
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 119/25
Më: 29.07.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesë për përfaqësimin brenda vendit

Neni 1

Për mysafirët nga Republika e Turqisë për nder të Festivalit të XVI ndërkombëtar të domates në Komunën e Mamushës. Pagesë për përfaqësimin brenda vendit tek Operatori Ekonomik Restarurant Suada Gorda B.I (Hyska) me nr. të faturës 475 i datës 28.07.2025 në shumën e përgjithshme prej 1,038.50 euro.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë nga kategoria mallra dhe shërbime- sipas nr. zotimit 2025-149748.

Përfutuesi	Nr. Unik	Xhirrollogaria	Shuma €
	810576423		1,038.50

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Me datën 23.07.2025 në Komunën e Mamushës është organizuar Festivali i XVI të Domates, ku në këtë festival morën pjesë shumë mysafir nga Qeveria, Ministrinë, Komunitet e tjera si dhe Europa, Ballkani si dhe nga Republika e Turqisë.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë Përkatese;
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing	No.Nr. 118-25
Tarih/Dt.	29.07.2025

ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 118/25

Më:29.07.2025

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M Pagesë për Akomodim

Neni 1

Për mysafirët nga Republika e Turqisë për nderë të Festivalit të XVI Ndërkombëtar të Domates në Komunën e Mamushës gjatë qëndrimit të tyre nga data 23.07.2025 deri më 25.07.2025. Pagesë për akomodim tek Operatori Ekonomik Mega Store SHPK (Classic Hotel) me nr. të faturës 396123, datë 24.07.2025, në shumën e përgjithshme prej 720.00€.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë nga kategoria mallra dhe shërbime- sipas nr. zotimit 2025-149754.

Përfituesi	Nr. Unik	Xhirrollogaria	Shuma €
Mega Store SHPK (Classic Hotel)	810968498	462.00 (100% të 462.00)	720.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me datën 23.07.2025 në Komunën e Mamushës është organizuar Festivali i XVI të Domates, ku në këtë festival morën pjesë shumë mysafir nga Qeveria, Ministrinë, Komunitet tjerë si dhe Europa, Ballkani si dhe nga Republika e Turqisë.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtoria e Bujqësisë;
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniq





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 117/25

Më:29.07.2025

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M Pagesë për Akomodim

Neni 1

Për mysafirët nga Republika e Turqisë për nder të Festivalit të XVI ndërkombëtar të domates në Komunën e Mamushës gjatë qëndrimit të tyre nga data 21.07.2025 deri më 26.07.2024. Pagesë akomodim tek Operatori Ekonomik Hotel Cleon SHPK me nr. të faturës 1202 data 25.07.2025 në shumën e përgjithshme prej 1,170.00 euro.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë nga kategoria mallra dhe shërbime- sipas nr. zotimit 2025-149769.

Përfituesi	Nr. Unik	Xhirrollogaria	Shuma €
Hotel Cleon SHPK	810600818	1,170.00	1,170.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me datën 23.07.2025 në Komunën e Mamushës është organizuar Festivali i XVI të Domates, ku në këtë festival morën pjesë shumë mysafir nga Qeveria, Ministrinë, Komunitat e tjera si dhe Europa, Ballkani si dhe nga Republika e Turqisë.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë Përkatëse;
2. Palëve;
3. Arkiva


Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 116/25
Më: 29.07.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M Pagesë për Akomodim

Neni 1

Për mysafirët nga Republika e Turqisë për nder të Festivalit të XVI ndërkombëtar të domates në Komunën e Mamushës gjatë qëndrimit të tyre nga data 22.07.2025 deri më 25.07.2025. Pagesë akomodim tek Operatori Ekonomik Hotel Theranda SHPK me nr. të faturës 25.07.2025 data 25.07.2025 në shumën e përgjithshme prej 4346.00 euro.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë nga kategoria mallra dhe shërbime- sipas nr. zotimit 2025-149762.

Përfituesi	Nr. Unik	Xhirrollogaria	Shuma €
Hotel Theranda SHPK	810608945	149762-2025	4,346.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me datën 23.07.2025 në Komunën e Mamushës është organizuar Festivali i XVI të Domates, ku në këtë festival morën pjesë shumë mysafir nga Qeveria, Ministrinë, Komunitet të tjera si dhe Europa, Ballkani si dhe nga Republika e Turqisë.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë Përkatesë;
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës



Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Mamuşa Selediyesi-Komuna e Mamuşës
 Opština Mamuşa-Municipality of Mamuşa

Çıkış - Dalışe - Izlazna - Outgoing

02 No.Nr. 115-25

hriyyeti

soyad. 28-07-2025

mushës


lamusa

Abdilhadi Krasnić



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 114 -25
Me 28 / 02 -2025
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës për aktivitetin e prokurimit " FURNIZIM ME APARAT FOTOGRAFIK DHE DRON PËR NEVOJAT E KOMUNËS "

NENI 1

Z. Yahya Şala Drejtor i Administratës së Përgjithshme Caktohet personi përgjegjës nga Njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës për aktivitetin e prokurimit " FURNIZIM ME APARAT FOTOGRAFIK DHE DRON PËR NEVOJAT E KOMUNËS "

NENI 2

Personi përgjegjës sipas nenit 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës, duke u bazuar në Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.

NENI 3

Obligohet- zyrtari përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës që në bazë të nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.

3.1. Deklaratë me të cilën deklarohet se specifikimet teknike/ termat e referencës janë në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike/ termat e referencës janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3.2. që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

3.3 Obligohet personi përgjegjës që se bashku me Specifikimet teknike/ termat e referencës të plotësoj dhe të dorëzojë Deklaratën nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP.

NENI 4

Personi përgjegjës obligohet që ta dorëzoj specifikat teknike të hartuara tek Njësia Kërkuese me qëllim të Inicimit të Procedurës së Prokurimit.

NENI 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në përputhje me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin, Njësia Kërkuese ka për obligim të caktojë një person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike apo termave të referencës për çdo aktivitet prokurimi.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë dokumente kyçe për zhvillimin e një procedure transparente dhe efikase të prokurimit, të cilat duhet të përpilohen në pajtim të plotë me dispozitat ligjore, duke garantuar konkurrencë të ndershme dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar. Përgatitja e saktë dhe e paanshme e këtyre dokumenteve është thelbësore për të shmangur konfliktet e interesit, si dhe për të siguruar suksesin e aktivitetit të prokurimit në të gjitha fazat e tij.

Në këtë drejtim, për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe për të siguruar cilësi dhe përgjegjësi institucionale në hartimin e dokumentacionit të prokurimit, caktohet personi përgjegjës sipas dispozitave në vijim të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. I/E caktuari/a
2. Drejtorisë përkatëse.
3. Zyra e Prokurimit dhe
4. Arkiva.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülkadi Krasniç



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing	02 No.Nr. 113-25
Tarih/Dt.	17.07.2025

02 Nr. 113/25
Me 17.07.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug 02/Nr.68/24 e datës 02.10.2024, Raportin e Agjencisë për zhvillim Rajonal Jug e datës 16.07.2025 dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug

Neni 1

Komuna e Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal me qëllim të krijimit të vendeve të punës në Komunën e Mamushës dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale të Komunës së Mamushës përmes projekteve të financuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme.

Neni 2

Bazuar në Memorandumin me nr. të protokollit 02/Nr-68-24 i datës 02.10.2024 përgjegjësitë e Komunës së Mamushës janë ta parapara në këtë Memorandum, gjegjësisht në nenin 3 paragrafi 3.2, ku si obligim e palëve të përcaktuar në këtë nen theksohet se Komuna e Mamushës financo projektin në fjalë.

Neni 3

Mjetet që lejohen në shumën prej 5,036,36.00 € sipas Raportin e Agjencisë për Zhvillim Rajonal Jug e datës 16.07.2025, pagesa për periudhën e muajit korrik 2025, sipas numrit të zotimit 2025-129258.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
2. Palëve
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës
Abdullah Krasniq



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çıkış - Dalëse - Izlaza - Outgoing	02
No.Nr.	112-25
Tarih/Dt.	09.07.2025

02.Nr. 112/2025

Me_09.07.2025 Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neni 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushës, të dates 01.12.2008 Kryetarui I Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesë e Kujdestarisë QKMF - Mamushë

Neni . 1

Aprovohet kërkesa e Qendrës së Mjekësisë Familjare-Mamushë për pagesën e kujdestarisë, per muajin **Qershor/2025**,

Neni . 2

Mjetet që lejohen për pagesë janë te dedikuara për periudhen **01.06.2025 deri 30.06.2025**, ne shumën prej **2.782,20 €** nga programi **Sherbimet e Shëndetësisë Primare**, kodi **73850** nga kategoria paga dhe mëditje.

Neni . 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtëvendim të njoftohet :

1. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirqenje Sociale
2. Departamenti i pagave-Thesar
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Nr. 02- 111 2025

Datë: 03.07.2025

Mamushë

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008, si dhe Marrëveshjen për bashkëpunim me numër të protokollit 09.Nr. 014/25 e datës 09.06.2025 të nënshkruar në mes të Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TİKA) dhe Komunës së Mamushës, nenit 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për Zbatimin e Projektit për Mbështetje të Mekanizimit Bujqësor në Bashkëpunim me TİKA-n

Neni 1

Themelohet Komisioni për zbatimin e projektit “Mbështetje për Mekanizimin Bujqësor të Fermerëve të Komunës së Mamushës” në bashkëpunim me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TİKA), i cili ka për qëllim shpërndarjen e makinerive spërkatëse për traktorë me kapacitet 400 litra për 200 fermerë nga territori i Komunës së Mamushës, në bazë të marrëveshjes me numër protokollit 09.Nr. 014/25, datë 09.06.2025.

Neni 2

Për zbatimin e projektit të përmendur, Drejtoria për Bujqësi e Komunës së Mamushës, ka udhëhequr procesin e pranimi të aplikacioneve nga fermerët në përputhje me kriteret e përcaktuara në njoftim publik.

Neni 3

Për shqyrtimin e kërkesave të aplikantëve për përfitim nga ky projekt, emërohet Komisioni përkatës në këtë përbërje prej **7 anëtarësh**:

1. Hacı Mazrek – Kryesues
2. Rujdi Mazrek – Anëtar
3. Levent Mazrek – Anëtar
4. Yahya Şala – Anëtar
5. Türker Mazrek – Anëtar
6. Erdinç Morina – Anëtar
7. Labinot Muhaxheri – Anëtar

Neni 4

Komisioni ka për detyrë shqyrtimin e aplikacioneve të fermerëve, vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, si dhe përpilimin e listës përfundimtare të përfituesve në përputhje me kriteret dhe udhëzimet e projektit. Komisioni obligohet të punojë në mënyrë të paanshme, transparente dhe profesionale.

ARSYETIM

Ky vendim merret me qëllim të sigurimit të një procesi të qartë, të drejtë dhe transparent për zbatimin e projektit për mbështetjen e mekanizimit bujqësor në Komunën e Mamushës, në bashkëpunim me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim – TİKA. Projekti parashikon shpërndarjen e 200 makinerive spërkatëse me kapacitet 400 litra për traktorë, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve teknologjike të fermerëve dhe rritjen e efikasitetit në prodhimin bujqësor në nivel lokal.

Për realizimin e objektivave të projektit, është e domosdoshme që procesi i pranimit, shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve të bëhet në mënyrë profesionale dhe objektive, duke u bazuar në kriteret të qarta dhe të drejtëpërdrejta. Emërimi i Komisionit të posaçëm me përbërje të përcaktuar nga ky vendim synon të krijojë një strukturë përgjegjëse, e cila do të monitorojë dhe udhëheqë procesin e përzgjedhjes së përfituesve në përputhje me udhëzimet dhe ligjet në fuqi.

Anëtarët e komisionit janë të ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikantët, vlerësimit të plotësisë dhe përputhshmërisë së tyre me kriteret e përcaktuara, si dhe përpilimit të listës përfundimtare të përfituesve. Komisioni do të veprojë në mënyrë të paanshme, transparente dhe profesionale, duke shmangur ndikimet e jashtme dhe duke garantuar integritetin e procesit. Kjo qasje përforcon besueshmërinë e vendimmarrjes institucionale dhe ndihmon në krijimin e një mjedisi ku çdo vendim merret mbi baza objektive dhe të dokumentuara.

Nëpërmjet këtij vendimi, synohet gjithashtu rritja e përgjegjshmërisë institucionale dhe transparencës në menaxhimin e burimeve publike, duke siguruar që përfituesit të jenë ata që plotësojnë kriteret e drejtëpërdrejta dhe që do të kenë ndikim real në zhvillimin e bujqësisë lokale.


Në këtë mënyrë, vendimi kontribuon në realizimin efektiv dhe ligjor të qëllimeve të projektit dhe përmirësimin e jetës së fermerëve në Komunën e Mamushës.

Me këtë njoftohet

- Anëtarët
- Drejtoria e Bujqësisë
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës


Abdullahi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 110/25
Me 03.07.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligji nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës me datën 10.01.2025 bie këtë:

V E N D I M Për pagesën Retroaktive Neni 1

Z. Nazmi Morina nga Komuna e Mamushës, , në bazë të Akt emërimit të Punës me numër të protokollit 0112/25 të datës 21.05.2025 me titull të pozitës Udhëheqës i sektorit për Gjendjes Civile.

Neni 2

Obligohet Zyra e Personelit që për të lartcekurin të përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të pagesës retroaktive në bazë të Vendimit për hyrje në listë të pagave me numër të protokollit 02-83-25 të datës 09.06.2025, me titull të pozitës Udhëheqës i sektorit për Gjendjes Civile për pagesën e diferencës retroaktive për pagën në shumën prej 97.20 € Bruto.

Neni 3

Paga do të bëhet duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Klasa GJ8 Koeficienti 7.66, sipas nën programit 10-626-16314-0133.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Z. Nazmi Morina, me datën 21.05.2025 ka nënshkruar Akt emërimit e punës në pozitën Udhëheqës i sektorit për Gjendjes Civile. Po të njëjtën ditë, më 10.06.2025, është përpiluar dhe dërguar vendimi për hyrje në listë të pagave me numër protokollit 02-83-25, përmes zyrës së personelit, drejtuar sistemit të Thesarit – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Në këtë vendim është përfshirë edhe pjesa për pagesën retroaktive për periudhën nga data 21.05.2025 deri me datën 31.05.2025, e cila përbën gjithsej 10 ditë pune, dhe që korrespondon me shumën e plotë bruto prej 97.20 €, bazuar në koeficientin përkatës sipas Ligji nr. 08/1-196 Për Pagat në Sektorin Publik.

Megjithatë, në listën e pagave të realizuar, është evidentuar se z. Nazmi Morina është paguar vetëm paga për një muaj, duke mos u reflektuar në mënyrë të saktë pagesa e plotë për ditët e punës së realizuara nga data 21.05.2025 deri me datën 31.05.2025.

Përkundër faktit që dokumentacioni i nevojshëm për pagesën retroaktive është dërguar me kohë dhe në përputhje me procedurat ligjore dhe administrative, kjo pagesë ende nuk është realizuar, duke lënë një diferencë të papaguar në shumën 97.20 € bruto. Kjo shumë përfaqëson të drejtën ligjore të të punësuarit dhe duhet të kompensohet sa më parë për të shmangur shkeljen e të drejtave financiare të tij.

Ky vendim ka për qëllim korrigjimin e këtij lëshimi dhe garantimin e shlyerjes së plotë të obligimeve financiare ndaj z. Nazmi Morina.

Me këtë vendim njoftohet :


- Zyra e Personelit
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 109/25
Me 03.07/25
Mamushë

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës merrë këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për monitorimin e fushatës korrje – shirje për vitin 2025 në komunën e Mamushës

Neni 1

Formohet komisioni për monitorimin e fushatës së korrje-shirjeve të drithërave për vitin 2025 në Komunën e Mamushës, në përbërje si më poshtë:

1. **Engin Taç**– Kryesues i komisionit
2. **Rahman Morina** – Anëtar
3. **Erدين Morina** – Anëtar

Neni 2

Komisioni ka për detyrë monitorimin, organizimin dhe menaxhimin e ecursisë së procesit të korrje-shirjeve, në bashkëpunim të ngushtë me fermerët dhe pronarët e autokombajnave.

Neni 3

Komisioni obligohet që të gjitha detyrat t'i realizojë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Komisioni i përmendur në nenin 1 të këtij vendimi fillon punën menjëherë dhe vazhdon deri në përfundimin e sezonës së korrje-shirjeve për vitin 2025.

Neni 5

Komisioni është i obliguar të raportojë një herë në javë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Komisionin Qendror për Monitorimin e Korrje-Shirjeve, si dhe të hartojë raport të rregullt me shkrim për Kryetarin e Komunës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

ARSYETIM

Komuna e Mamushës, si zonë me aktivitet të theksuar bujqësor, çdo vit zhvillon fushata intensive të korrje-shirjes së kulturave të drithit. Për të siguruar një proces të koordinuar, të sigurt, efikas dhe me ndikim sa më pozitiv për fermerët lokalë, është e domosdoshme formimi i një komisioni mbikëqyrës.

Ky komision do të ndihmojë në organizimin praktik të korrje-shirjeve, në komunikimin me pronarët e autokombajnave, si dhe në zgjidhjen e çështjeve teknike dhe logjistike që mund të paraqiten gjatë sezonës.

Gjithashtu, raportimi i rregullt ndaj instancave qendrore dhe komunale garanton transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm të procesit bujqësor. Vendimi bazohet në nevojat reale të terrenit dhe është në përputhje me ligjet dhe politikat bujqësore në fuqi.

Me këtë vendim njoftohet :


- Anëtarët e Komisionit,
- Drejtoria komunale për Bujqësi dhe
- Arkivi.

Kryetari i Komunës së Mamushës
Abdullahi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 108/25

Me 03.07.2025

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, lidhur me Ligji nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me nenin 68 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës lidhur me nenet 74 paragrafi 1 pika 1.7, neni 75 dhe 87 paragrafi 1 i Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr.08/L-197, si dhe nenit 82 të Statutit të komunës së Mamushës dhe lidhur me vendimin 02.Nr.107/5 të datës 03.07.2025, kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Për largimin nga Lista e Pagave

Neni 1

Në bazë të vendimit nr. 02.Nr.107/25, të datës 03.07.2025, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje, z. Belhid Skenderi largohet nga lista e pagave nga data 01.07.2025, në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare – Mamushë, nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që, pas nënshkrimit të këtij vendimi, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për largimin e z. Belhid Skenderi nga lista e pagave dhe përditësimin e të dhënave në sistemin administrativ përkatës.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.07.2025 dhe nga ai moment krijon pasoja juridike për palët e përfshira, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

A R S Y E T I M

Z. Belhid Skenderi, i sistemuar në pozitën Mjek i Përgjithshëm pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Mamushës, ka paraqitur dorëheqjen e tij me vullnet të lirë, e cila është pranuar me vendimin nr. 02.Nr.107/25, të datës 03.07.2025. Në përputhje me këtë vendim, marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë me datën 01.07.2025.


Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, si dhe në rregulloret përkatëse për administrimin e listës së pagave, z. Belhid Skenderi duhet të largohet nga lista e pagës, duke reflektuar gjendjen reale të marrëdhënies së tij të punës.

Ky veprim synon të sigurojë përputhshmëri me kornizën ligjore dhe menaxhim të drejtë të burimeve financiare të Komunës.

Njoftohen

1. Z. Belhid Skenderi
2. DSHMS.
3. Thesari
4. ARKIVI

Kryetari i Komunës së Mamushës


Abdülhadi Krasniç



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS
02- Nr.107-25
Me datë 03.07.2025

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 68 lidhur me nenin 69 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, në lidhje me nenet 74 paragrafi 1 pika 1.7, neni 75 dhe 87 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr. 08/L-197, deklaratës për dorëheqje nga marrëdhënia e punës me nr. protokollin 08.Nr-14-25, si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

AKT V E N D I M

Mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje të nëpunësit publik

Neni I

~~V. Bejta Shkurtaj~~, me numër personal ~~7777777~~, i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, i sistemuar në vendin e punës sipas kontratës si Mjek i Përgjithshëm pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë, i përfundon marrëdhënia e punës në Shërbimin Publik me datën 01.07.2025, në bazë të dorëheqjes së tij të paraqitur me vullnet të lirë.

Neni II

Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që, nga data 01.07.2025, ta largojë të lartpërmendurin nga lista e pagave, si dhe të ndërmarrë veprimet përkatëse administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni III

Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.07.2025 dhe nga ai moment krijon pasoja juridike për palët e përfshira, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

A R S Y E T I M

~~V. Bejta Shkurtaj~~, me numër personal ~~7777777~~, nga Komuna e Prizrenit, ka ushtruar detyrën e Mjekut të Përgjithshëm pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë, në përputhje me kontratën individuale të punës dhe detyrat e përcaktuara, deri më datën 01.07.2025, kur edhe i ndërpritet marrëdhënia e punës në Shërbimin Publik, në bazë të dorëheqjes së paraqitur me vullnet të lirë.


~~V. Bejta Shkurtaj~~, në cilësinë e nëpunësit publik, përmes një letre dorëheqjeje, i është drejtuar Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, duke paraqitur deklaratën për dorëheqje me datë 20.06.2025, e protokolluar me nr. 08.Nr.14-25, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në Shërbimin Publik, në pozitën Mjek i Përgjithshëm pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë.

Marrëdhënia e punës i ndërpritet duke filluar nga data 01.07.2025, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me vullnetin e lirë të nëpunësit publik.

Andaj, pas administrimit të provave dhe fakteve lidhur me gjendjen faktike, si dhe duke u bazuar në arsyetimet e paraqitura në letrën e dorëheqjes të z. Belhid Skenderi, në cilësinë e Mjekut të Përgjithshëm pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë, dorëheqja nga Shërbimi Publik është pranuar dhe është vendosur sipas dispozitivit të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala ka të drejtë ankese brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit, pranë Komisionit Komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Të njoftohen :
z. Belhid Skenderi
DSHMS
Zyra e Personelit
Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullhadi Krasniqi



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 106/25
Më: 03.07.2025
Mamushë

Në bazë të Memos dërguar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, sipas nenit 10 (b) dhe nenit 15 të LMFPP, bazuar në shkresën Nr.04 datë 12.01.2021 lidhur me ciklin e ekzekutimit të buxhetit për vitin fiskal 2021. Nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Zëvendësimi i përkohshëm i funksionit të ZKF-së

Neni 1

z.Aziz Elshani (ID-1006811139), caktohet për zëvendës i Zyrtarit Kryesor Financiar (të përkohshëm).

Neni 2

Obligohet: z.Aziz Elshani zëvendësues i përkohshëm Zyrtar Kryesor Financiar, që për gjatë kohës sa znj. Xhevahire Rushiti gjendet në pushim, apo udhëtim zyrtar, që ti kryej të gjitha përgjegjësit dhe detyrat të cilat i vihen në barrë të Zyrtarit Kryesor Financiar

Neni 3

Periudha e zëvendësimit fillon nga data 07.07.2025 deri më 11.07.2025.

Neni 3

Zëvendësuesi/ja i Zyrtarit Kryesor Financiar i ushtron të gjitha përgjegjësit e parashikuara sipas nenit 12 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë 03/L-48, Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike 06/L-021, Ligjin e Buxhetit për vitin 2021 si dhe akteve nënligjore duke përfshirë shkresën Qarkore të datës 12.01.2021, si dhe ushtron të drejtën e qasjes në SIMFK dhe sipas shkresës së Thesarit datë 01.01.2021 Nr 04 në rolin dhe funksionin e Zyrtarit Kryesor Financiar deri në kthimin e ZKF-ës në detyrë, nënshkruan të gjitha dokumentet nën përgjegjësi të ZKF-ës.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga data e nënshkrimit të tijë.

Me këtë vendim njoftohet :

- I/e zëvendësuesi i ZKF-ës
- Departamenti i Përgjithshëm Thesarit-MFPT
- znj. Xhevahire Gashi – Zyrtar Kryesor Financiar
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës
Abdullahi Krasniç



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 105-25
Me 02/07/2025
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 5, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-023 për Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht të Gjirit, nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publikë, Kërkesën me nr. Protokolli 08.Nr.13-25 e datës 02.07.2025 dhe Raporti i DSHMC me nr. Protokollit 02.Nr.41-25 e datës 02.07.2025 si dhe në përputhje me Statutin e Komunës së Mamushës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e ushqimit të foshnjës me qumësht gjiri

Neni 1

Aprovohet: kërkesa me nr. protokolli 08.Nr.13-25 e datës 02.07.2025, drejtuar Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me anë të së cilës znj. Arzu Orçuša nga Prizreni, e sistemuar në pozitën Mjeke e Përgjithshme në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë, ka kërkuar të drejtën për shfrytëzimin e pushimit me pagesë për ushqimin e foshnjës me qumësht gjiri *si e bazuar*.

Neni 2

Znj. Arzu Orçuša, në cilësinë e nënë që ushqen foshnjën me qumësht gjiri, pas përfundimit të vitit të parë të jetës së fëmijës deri në moshën dy (2) vjeçare, gëzon të drejtën për një (1) orë pushim me pagesë në ditë, brenda orarit të rregullt të punës. Ky pushim shfrytëzohet ekskluzivisht për qëllime të ushqyerjes së foshnjës me qumësht gjiri dhe nuk përfshin pushimin e rregullt gjatë orarit të punës.

Neni 3

Obligohet: Udhëheqësi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë të koordinojë me znj. Arzu Orçuša kohën për shfrytëzimin e këtij pushimi, i cili mund të realizohet në fillim, në mes apo në fund të orarit të punës, në varësi të nevojave të saj dhe mundësive organizative të institucionit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

znj. Arzu Orçuša, e sistemuar në pozitën Mjeke e Përgjithshme në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Mamushës, ka paraqitur kërkesën me nr. protokolli 08.Nr.13-25 e datës 02.07.2025, me të cilën ka kërkuar shfrytëzimin e pushimit me pagesë për ushqimin e binjakëve të saj me qumësht gjiri. Kërkesës i është bashkëngjitur edhe vërtetimi i mjekut specialist, me të cilin konfirmohet se znj. Orçuša është nënë e binjakëve që ushqehen me qumësht gjiri.

Provë: Vërtetim nga Mjeku Specialist

Andaj, pas administrimit të provave dhe fakteve lidhur me gjendjen faktike, shqyrtimi i kërkesës është e bazuar dhe gjen mbështetje në dispozitat e nenit 5, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-023 për Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht të Gjirit. Me të cilin garanton të drejtën e nënës së punësuar për të përfituar një (1) orë pushim me pagesë gjatë ditës së punës, për ushqimin e foshnjës me qumësht gjiri, deri në moshën dy (2) vjeçare të fëmijës. Qëllimi i këtij ligji është promovimi, mbrojtja dhe mbështetja e ushqyerjes me qumësht gjiri, si një praktikë thelbësore për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës, por edhe për mirëqenien e nënës.

Në të njëjtën frymë, edhe Rregullorja (QRK) Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publikë, në nenin 13, paragrafi 4, e trajton këtë pushim si një të drejtë të veçantë, të pavarur dhe të patjetërsueshme. Kjo dispozitë nënvizon qartë se pushimi njëorësh për ushqimin e foshnjës me qumësht gjiri nuk duhet të ngatërrohet apo zëvendësohet me pushimin e rregullt gjatë orarit të punës. Kjo ndarje synon të sigurojë që nëna punonjëse të ketë kohën e nevojshme, të garantuar me ligj, për t'iu përkushtuar ushqyerjes së fëmijës, pa cenuar të drejtat e saj të tjera që i takojnë nga marrëdhënia e punës.

Koordinimi i kohës së pushimit bëhet me marrëveshje ndërmjet znj. Arzu Orçuša dhe Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë, i cili siguron organizimin e brendshëm efikas dhe funksionalitet të pandërprerë të shërbimeve mjekësore, duke respektuar njëkohësisht të drejtën e punonjëses për pushimin ligjor të garantuar.

Andaj, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa të Komunës së Mamushës, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Me këtë njoftohen

- znj. Arzu Orçuša
- QKMF
- Personeli
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 104/25
Me 01.07.2025
Mamushë



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Trajnim në SIMFK moduli Të Hyra

Neni 1

z.Alban Sadiki - Zyrtar i Pausrisë, obligohet të e ndjek trajnimin për modulin Të Hyra sipas procedurave të Thesarit.

Neni 2

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet :

- z.Alban Sadiki
- Agjensioni i Thesarit-MFPT
- Arkiva

